

Prof. as. dr. Valter MEMISHA
Manjola BREGASI

FJALOR I EMËRTIMEVE TË SHKURTUARA NË SHQIPE

Një fjalor hartohet për të dhënë informacion. Lloji dhe qëllimi i përdorimit të këtij informacioni, struktura dhe mundësia e shfrytëzimit, jetëgjatësia dhe mundësitë e përditësimit të tij përcaktojnë tipin e fjalorit.

Franz Josef Hausmann e përkufizon fjalorin si një *përmbledhje të njësisve* leksikore, të cilat japin *informacione* të caktuara për *përdorues* të caktuar dhe që paraqiten përmes një *mediumi* të caktuar, duke u radhitur në mënyrë të tillë që për secilin informacion, të jetë e mundshme një qasje praktike dhe e shpejtë¹. Nga ky përcaktim nxjerrim tre përbërës të rëndësishëm: *informacionin leksikor*, *mediumin e paraqitjes (që lidhet me fjalorin si mjet)* dhe *përdoruesin e këtij informacioni* që nënkupton shfrytëzuesin e informacionit që mbart fjalori.

1. Duke u mbështetur te lloji i informacionit, në praktikën leksikografike njihen dy lloje fjalorësh²: *fjalorë gjuhësorë*, të cilët mund të jenë të tipave të ndryshëm (të vegjël, të mesëm a të mëdhenj), ashtu si mund të jenë njëgjuhësh a dy- e shumëgjuhësh, shpjegues, terminologjikë, frazeologjikë, sinonimikë, antonimikë, etimologjikë, drejtshkrimorë, shkollorë etj.; *jogjuhësorë*, të cilët së pari nënkuptojnë fjalorët enciklopedikë.

2. Nga lloji i mediumit të paraqitjes, si mjet përdormi e shfrytëzimi fjalorët mund të jenë të shtypur (*print dictionaries*) ose elektronikë³.

3. Një fjalor gjuhësor i veçantë që mund të jetë i shtypur ose elektronik, është edhe ai që lidhet me *emërtimet e shkurtuara*.

Veçantinë atij ia jep lënda leksikografike që pasqyron. Ajo nuk jep listë fjalësh a të shpjegojë fjalë. Lëma në një fjalor të tillë del si paraqitëse simbolike e një emërtimi të pathjeshtë (i ndërtuar nga dy a më shumë fjalë).

Emërtimet e shkurtuara janë realitete gjuhësore, sidomos në gjuhën e shkruar dhe tashmë shpesh flitet për to si realitete leksikografike. Dihet se *krijimi i emërtimeve të shkurtuara është një prirje e brendshme e çdo gjuhe*. Shqipja ka me dhjetëra fusha leksikore që përfshijnë qindra a mijëra njësi të tilla, që sot po shtohen me shpejtësi të madhe.

Kohët e fundit doli nga shtypi *Fjalori i emërtimeve të shkurtuara*, i cili përmban rreth 2.500 njësisish.

Lidhur me *strukturën e fjalorit*, që në krye, duhet të pohojmë se, pavarësisht nga tradita ndërkombëtare, jemi gjendur para një dukurie të ndërlikuar. Lënda leksikografike e përzgjedhur, është heterogjene, sepse vetë koncepti emërtime të shkurtuara është përfshirës.

Pasqyrimi leksikografik i emërtimeve të shkurtuara të gjuhës shqipe nuk ka qenë i plotë. Paraqitja e parë është bërë në *Fjalorin e Shqipes së Sotme* (1984), ku u përfshinë në formë shtojce **300 shkurtesa e shkurtime**, por fjalorët e tjerë shpjegues nuk kanë përfshirë rregullisht emërtime të shkurtuara.

Në disa fjalorë dygjuhësh janë paraqitur emërtime të shkurtuara (shkurtesa, shkurtime, simbole etj.) si zë më vete. Kështu, *Fjalori italisht-shqip*, 2006⁴, i hartuar nga F. Leka e Z. Simoni, ka qindra shkurtesa që lidhen me gjuhën italiane; *Fjalori anglisht-shqip*, 2002⁵, i hartuar nga P. Qesku ka rreth 4000 njësi, *Fjalori gjermanisht-shqip*, 2004⁶, i hartuar nga A. Dhrimo, ka disa qindra të tilla. Edhe pse emërtimet e shkurtuara në këta fjalorë janë të lidhura në radhë të parë me gjuhët e huaja, ato i takojnë edhe leksikografisë shqipe, pasi shqipja ka në përdorim një numër jo të vogël prej tyre e sidomos shkurtesa të huazuara *ndërkombëtarizma*.

Tradita ndërkombëtare njeh tri mënyra lidhur me paraqitjen leksikografike:

a. Fjalorë të mirëfilltë emërtimeve të shkurtuara, sidomos për gjuhët me shkallë të lartë përpunimi, me traditë leksikografike dhe me numër të madh përdoruesish. (Fjalori i parë i emërtimeve të shkurtuara në anglishte ka dalë më 1886 dhe përfshin rreth 2500 njësi⁷).

Në gjysmën e dytë të shek. XX numri i fjalorëve të këtij lloji u rrit ndjeshëm. *Fjalori i akronimeve dhe i inicializmave*⁸ i Robert C. Thomas, në botimin e tretë më 1970 përfshin mbi 80.000 njësi, kurse *Fjalori i shkurtimeve*⁹ i Ralph de Solës, botuar më 1973 përfshin 160.000 njësi. Sot në internet, pra në formë elektronike, gjejmë fjalorë tematikë, por edhe fjalorë përfshirës tek të cilët numri i emërtimeve të shkurtuara lëviz nga 600.000 deri 3.000.000.

b. Tradita botërore njih pasqyrimin e emërtimeve të shkurtuara edhe si shtojca në fund të fjalorëve njëgjuhësh a dy- e shumëgjuhësh (p.sh. në *Oxford Advanced Learner's Dictionary of Current English*" Appendix 2).

c. Interesante në botimet e fundit të Oxfordit, dhe jo vetëm në botimet e këtij enti, është mënyra e paraqitjes së emërtimeve të shkurtuara *shkurtesa* si leksema. Kjo do të thotë se shkurtesat janë pranuar si njësi të mëvetësishme dhe përdorimi i tyre nuk kërkon domosdoshmërisht përdorimin e emërimit të plotë.

Lënda specifike e fjalorëve të tillë kërkon zgjidhje leksikografike të veçanta. Ne përditë ndeshemi me larmi procesesh shkurtimi, pasojë e të cilave është larmia e emërtimeve të shkurtuara, një pjesë shumë e madhe e të cilave nuk dalin si njësi leksemore. Kjo ka kërkuar përcaktimin e saktë të grupeve paradigmatisht të njësisive që pasqyrohen në fjalor.

Mendojmë se shqipes i duhet një fjalor i *emërtimeve të shkurtuara*, edhe pse ato formojnë *një klasë heterogjene* tipash, nëntipash a njësisish. Kjo çon domosdoshmërisht te përcaktimi i saktë i *procesit* dhe i *emërimit*.

Në literaturën gjuhësore e jashtëgjuhësore përdoren shpesh termat shqip *emërtim i shkurtuar*, *shkurtime* dhe *shkurtesë*, si dhe termat e huaj *abreviacion*, *abreviaturë*, *akronim*, *inicializëm*, *alfabetizëm* etj. Mund të japim këtu shkurt kuptimin e këtyre termave.

Termi *emërtim i shkurtuar* (dhe *abreviacion*) është përdorur si term përfshirës, hiperonimik. Në klasën e njësisive nën këtë emërtim futen të gjitha njësitë që i nënshtrohen shkurtime. Nuk i kemi zgjeruar kufijtë me njësi që i janë nënshtroar rënies së tingujve (si *afereza*, *sinkopa*, *apokopa* etj.).

Termi *shkurtime* përmban edhe veprimin e foljes *shkurtoj*, edhe përfundimin, rezultatin e këtij veprimi¹⁰. Ai nënkupton paraqitjen

e një fjale a të një grupi fjalësh në trajtë të shkurtuar, që bëhet për ta shkruar atë më shpejt dhe më shkurt (*km.* “kilometër”, *p.sh.* “për shembull” etj.)¹¹.

A. Shkurtime (shkurtesa grafike¹², shkurtime grafike fjalësh¹³) nuk janë fjalë të mëvetësishme, por *paraqitje shkronjore* e një fjale a një grupi fjalësh në trajtë të shkurtuar për nevoja të ekonomizimit shkrimor. Prej këtej del se procesi i shkurtimeve lidhet kryesisht me variantin shkrimor të gjuhës. Shkurtimeve nuk funksionojnë si njësi në gjuhën e folur, nuk kanë kategori gramatikore, nuk funksionojnë si gjymtyrë fjalie, nuk kryejnë funksione sintaksore dhe mbeten thjesht problem i drejtshkrimit¹⁴. Shkurtimeve janë të shumta dhe degëzohen në nënfusha e mikrofusha. Lidhur me lëndën që përmban fjalori, po bëjmë këtu disa grupime dhe karakterizime të tipave kryesorë:

1. Shkurtime të *emërtimeve të titujve shkencorë, të profesioneve* etj.: *akad.* akademik, *prof.* profesor, *dr.* doktor, *agr.* agronom, *arkit.* arkitekt etj.

2. Shkurtime *në tekste, në monografi, në fjalorë të tipave të ndryshëm* etj. të elementeve plotësuese, si: *fig.* (kuptim i figurshëm), *keq.* (me kuptim keqësues), *libr.* (ligjërimit libror), *ndajf.* (ndajfolje), *pj.* (pjesëz), *përmb.* (emër përmbledhës), *vet. nj.* (përdoret vetëm në numrin njëjës), *thjeshtligj.* (ligjërimi i thjeshtë ose ligjërimi i shkujdesur), *tall.* (fjalë a shprehje tallëse) etj.

3. Shkurtime të *emërtimeve administrative*, të kontinenteve, të shteteve, të rretheve, të qyteteve etj.; *p.sh.* *AL* (Albania – Shqipëri), *RO* (Rumani) etj. Një syth më vete këtu do të përbënim shkurtimeve të emërtimeve të rretheve etj., që përdoren në targat e makinave si: *TR* (Tiranë), *DR* (Durrës) etj.

4. Shkurtime të *emërtimeve të elementeve kimike*, të quajtura ndryshe *simbole*, si: *Ar* (argjend), *Cu* (bakër) etj.

5. Shkurtime të *emërtimeve astronomike*, të cilat kanë hyrë në gjuhë të ndryshme si shkurtime të emërtimeve në latinisht: *And* (Andromeda), *U. Ma* (Ursa Major – Arusha e Madhe), *Gem* (Gemini – Binjakët) etj.

6. Shkurtime të *pikave të horizontit* si: *V* (Veri), *J* (Jug), *L* (Lindje), *P* (Perëndim), *JL* (Juglindje), *VP* (Veriperëndim) etj.

7. Shkurtime të *emërtimeve të njësive matëse*, të njësive të sistemit ndërkombëtar dhe të sistemit britanik:

a. Shkurtime të **emërtimeve të njësive matëse të gjatësisë**: mm (milimetër), cm (centimetër), dm (decimetër), m (metër), km (kilometër); in (inch / inç – 25,4mm), ft (foot / këmbë – 30,48 cm); yd (yard / jard – 0,9144 m), mi (milje / milje – 1, 6093 m), NM (nautic milje / milje detare – 1,852 m) etj.

b. Shkurtime të **njësive matëse të sipërfaqes**: mm² (milimetër katror), cm² (centimetër katror), dm² (decimetër katror), m² (metër katror), a (ar), ha (hektar), km² (kilometër katror); sq in (square inch / inç – 6,4516 cm²), sq ft (square foot / këmbë – 0,0929 m²) etj.

c. Shkurtime të **emërtimeve të njësive matëse të vëllimit**: mm³ (milimetër kub), cm³ (centimetër kub), dm³ (decimetër kub), m³ (metër kub) cu in (cubic inch / inç – 16,387 cm³), cu ft (cubic foot / këmbë – 28,317 dm³) etj.

ç. Shkurtime të **emërtimeve të njësive matëse të vëllimit të lëngjeve**, si: cl (centilitër), l (litër), dl (decilitër), pt (pint – 5,682 cl), qt (quart – 1,136 l), gal (gallon – 4,545 l), oil bbl (barrel petrol USA / fuçi naftë -158,970 l) etj.

d. Shkurtime të **emërtimeve të njësive matëse të peshës**: g (gram), kg (kilogram), kv (kuintal), t. (ton) dr (dram – 1,772 g), oz (ounce – 28,349 g), lb (pound – 0, 454 kg); ton l (long ton – 1,016 t) etj.

dh. Shkurtime të **emërtimeve të njësive matëse të shpejtësisë**: km / h (kilometër për orë), mi / h (milje për orë) etj.

8. Shkurtime **togfjalëshash a fjalësh emërtuese të prira nga para-fjalë**, që u përkasin fushave të ndryshme të botës materiale dhe shpirtërore; p.sh. (për shembull), p.e.s. (para erës sonë), p.s. (pas erës sonë), p.l.K (para lindjes së Krishtit), p.K. (pas lindjes së Krishtit) etj.

9. Shkurtime të emërtimeve të monedhave me përkatësinë shtetërore, si: USD (Dollari i Shteteve të Bashkuara); EURO (Monedha e Evropës së Bashkuar); GBP (Paundi i Britanisë së Madhe); CHF (Franga e Zvicrës) etj.

10. Shkurtime **fjalësh kemi edhe në fusha të tjera, si në fizikë, matematikë** etj., si Nj (Njuton), U (tension), g (Gravitacion) etj.

11. Shkurtime të **emrave e të mbiemrave të njerëzve a të pseudo-nimeve** të tyre etj.: A.XH. (Aleksandër Xhuvani, shkroi në “Kumtari Arsimuer” etj.), G.B. (Gaspër Beltoja, shkroi në “Shkolla e Re”), P.V.P. (Patër Vinçenc Prenushi, shkroi në “Zani i Shna Ndout”, 1917) etj.; shkurtime si emra të përveçëm njerëzish, të krijuara nga rrokjet nistore, si: Migjeni (Millosh Gjergj Nikolla); Lasgush (Lazër

Gusho), *Doku* (Donat Kurti, shkroi në “Hylli i dritës”) etj.; shkurtime mund të jenë krijuar nga shkronjat e para të emrit dhe të mbiemrit + rrokjen e parë të arealit gjeografik ku ka lindur mbartësi i këtij shkurtimi që përdoret si pseudonim, si: *Asdren* (Aleksandër Stavri Drenova) etj.

12. Grup më vete shkurtime **për fjali të llojeve të ndryshme** si ç.d.v. (çfarë deshëm vërtetë), f.v. (fjala vjen), b.f. bie fjala etj.

B. Shkurtesat (shkurtesa leksikore,¹⁵ shkurtime emërtime të përbëra¹⁶) janë fjalë të formuara nga bashkimi i dy a më shumë temave të shkurtuara të një emërtimi togfjalëshor a të një emërtimi të pathjeshtë; janë një lloj i veçantë kompozitash¹⁷.

Ndryshe nga shkurtime, shkurtesat funksionojnë si fjalë të mëvetësishme, me rrafshin e shprehjes dhe atë të përmbajtjes, shqiptohen si njësi të njëfjalësuar, marrin tregues gramatikorë dhe kryejnë funksione të ndryshme sintaksore. Kur krijohet një shkurtesë, rritet shkalla e abstraktimit, duke kaluar **një proces katërshkallësh**:

a. **Përdorimi i ogfjalëshit si emërtim i pathjeshtë** që kthehet në shkurtesë.

b. **Shkurtimi i emërtimeve** si gjymtyrë të emërimit të pathjeshtë dhe krijimi i shkurtesës.

c. **Përdorimi dysh** i emërimit të plotë edhe i shkurtesës.

d. **Shkëputja e shkurtesës** dhe përdorimi i saj si njësi e pavarur, por pa i shkëputur lidhjet, tashmë të pandërmjetësuar, nga togfjalëshi emërtim i pathjeshtë.

Shkurtesat përfshihen në fjalor; denduria e madhe në ligjërimet e shkruara ka qenë madje shtysa e hartimit të fjalorit. Në fillim fjalori u konceptua si fjalor shkurtesash, por gjatë ecurisë së punës e zgjeruam hapësirën, duke e kthyer në fjalor të emërtimeve të shkurtuara.

Shkurtesat sipas formimit janë të tipit **nistor-tingulloro-shkronjor** dhe të tipit **rrokjesor**.

Shkurtesat e **tipi nistor** mund t’i ndajmë në tre nëntipa¹⁸:

a. Shkurtesa të **nëntipit nistor-shkronjor**, ku përfshihen ato që formohen nga bashkimi i shkronjave të para (nistore) të fjalëve të një emërtimi të përbërë (të pathjeshtë), si: *ATSH* (Agjencia Telegrafike Shqiptare), *FMN* (Fondi Monetar Ndërkombëtar), *OKB* (Organizata e Kombeve të Bashkuara) etj. Në këtë nëntip shkurtesash lind raporti

në mes shkrimit dhe shqiptimit. Ato theksohen në rrokjen e fundit dhe zanorja *ë* bëhet në shqiptim mbështetëse për çdo bashkëtingëllore: *RTSH - Rëtëshë, OKB - Okëbë, ADN-Adënë* etj., pra shqiptohen si fjalë që mbarojnë me zanore të theksuar.

b. Shkurtesa të *nëntipit nistor-tingullor*. Këtu përfshihen emërtime që formohen nga bashkimi i tingujve nistorë të fjalëve të një emërtimi të përbërë. Këto shkurtesa shqiptohen *si një fjalë e zakonshme*, duke u lehtësuar nga prania e zanoret në përbërjen e tyre.

Këtu mund të dallojmë dy nëngrupe paradigmatiche njësisht:

b. 1. Shkurtesa që mbarojnë me bashkëtingëllore dhe që zanoren a zanoret i kanë në trup të temës, si: *TEC (Termoelektrocentral), BERZH (Banka Europiane për Rindërtim e Zhvillim)* etj.

b. 2. Shkurtesa që mbarojnë me zanore, si: *NATO (North Atlantic Treaty Organization), UEFA (Union European Football Associations), FIFA (Federation Internationale Football Association)* etj.

c. Shkurtesa të *nëntipit të përzier (shkronjor-tingullor ose tingullor shkronjor)*. Njësi të tilla shqiptohen sipas tingujve nistorë dhe shkronjave nistore, si: *OSBE (Osëbëe - Organizata për Siguri dhe bashkëpunim në Europë), DPCE (Dëpëcëe - Drejtoria e Përgjithshme e Centraleve Elektrike)* etj.

Grup të madh shkurtesash formojnë ato *të tipit rrokjesor*, grup që kohët e fundit është shtuar ndjeshëm: *INSIG (Instituti i Sigurimeve); Instat/INSTAT (Instituti i Statistikave); Sigma/SIGMA (Siguri e madhe); Albkrom (Bakri i Shqipërisë / shqiptar), Albakarta (Karta shqiptare), Albsig (Sigurimet në Shqipëri / shqiptare), Albtelekom (Telekomi i Shqipërisë / shqiptar), Albinvest (Investimet në Shqipëri / shqiptare), Albafilm (Filmi i Shqipërisë / shqiptar), Albaposta (Posta e Shqipërisë / shqiptare)* etj.

Këto shkurtesa i ndeshim në shumë gjuhë të tjera. Disa prej tyre përdoren si fjalë ndërkombëtare, si: *Beneluks (Belgium, Netherlands, Luksemburg); Interpol (Internacional Police - Policia Ndërkombëtare); Gestapo (Geheime Stats Police - Policia sekrete e shtetit)* etj.

Si te shkurtesat e tipit nistor, edhe tek ato të tipit rrokjesor kemi një prirje për formime të shumta. Kjo pashmangshmërisht të çon te shumë formime rastësore (okazionale). Prandaj një kërkesë e vazhdueshme dhe e detyrueshme për ne ka qenë përzgjedhja e atyre që do të zinin vend në fjalor.

Përdorimi i shpeshtë, por më shumë funksioni informativo-

ekonimizues, i përcaktuar edhe nga vlera e funksioni i realies që ato shënojnë, kanë kushtëzuar pasqyrimin leksikografik të tyre.

Shkurtesat formojnë një klasë të madhe e mjaft heterogjene, por që kanë krijuar tashmë një sistem të qartë strukturoro-funksional. Elementi i parë i karakterit sistemor të kësaj klase formimesh është fusha e veprimtarisë dhe fusha leksikore. Ka shumë fusha që shërbejnë si truall i krijimit dhe i përdorimit të këtyre emërtimeve.

a. Fusha leksikore me shkurtesa për partitë politike, si: *PR (Partia Republikane)*, *PDSH (Partia Demokratike Shqiptare)*, *BDI (Bashkimi Demokratik për Integrim)* etj.

b. Fusha leksikore e shkurtesave për institucionet shtetërore qendrore, si: *KSH (Kuvendi i Shqipërisë)*, *KM (Këshilli i Ministrave)*, *MASH (Ministria e Arsimit dhe e Shkencës)* etj.

c. Fusha leksikore e shkurtesave për gazetat e ndryshme, si: *RD (Rilindja Demokratike)*, *ZP (Zëri i Popullit)*, *GSH (Gazeta Shqiptare)* etj.

ç. Fusha leksikore e shkurtesave për stacionet televizive, si: *TVSH (Radiotelevizioni Publik Shqiptar)*, *BBC (British Broadcasting corporation / Televizioni i Korporatës Britanike për Radiopërhapjen)*, *RTP (Radiotelevizioni Prishtinës)* etj.

d. Fusha leksikore e shkurtesave për ndërmarrje tregtare, si: *NTU (Ndërmarrja Tregtare e Ushqimore)*, *ABCOM (Albanian Business Communication - Komunikimi i Biznesit Shqiptar)*, *NPV (Ndërmarrja e Prodhimit të Veshjeve)* etj.

dh. Fusha leksikore e shkurtesave për organizata joqeveritare e jofitimprurëse, si: *FFPBB (Federata e Familjes për Paqe Botërore dhe Bashkim)*, *KSHB (Komiteti Shqiptar i Birësimit)* etj.

e. Fusha leksikore e shkurtesave për shtetet, si: *USA / SHBA (Shtetet e Bashkuara të Ametikës)*, *URSS (Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike)*, *BE (Bashkimi Evropian)* etj.

ë. Fusha leksikore me shkurtesa nga bota e sportit, si *FSHF (Federata Shqiptare e Futbollit)*, *FIFA (Federation Internationale Football Association / Bashkimi i Federatave Ndërkombëtare të Futbollit)* etj.

f. Fusha leksikore me shkurtesa nga mjekësia, si: *AIDS / SIDA (Acquired Immaline Deficiency Syndrome)* etj.

g. Fusha leksikore me shkurtesa nga jeta ushtarake, si: *MKZ (Mbrotjtja Kundër Zjarrit)*, *BETOK (Betejë tokësore)*, *QZ (Qendër Zjarri)* etj.

gj. Fusha lektikore me emërtime nga ekonomia dhe bankat, si: BEI (Banka Europiane e Investimeve), BSHSH (Banka e Shtetit Shqiptar), BIA (Banka Italo-Shqiptare) etj.

h. Fusha leksikore me shkurtesa emërtime të instituteve të ndryshme, si: INSIG (Instituti i Sigurimeve), ISB (Instituti i Studimeve Bashkëkohore), QSGJ (Qendra e Studimeve Gjeografike), IGJL (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë) etj.

i. Fusha leksikore me shkurtesa për institucionet arsimore të larta a të mesme etj.: UT (Universiteti i Tetovës), UT (Universiteti i Tiranës), UV (Universiteti i Vlorës), UP (Universiteti i Prishtinës) etj.

Në një prerje tjetër për grupin e shkurtesave kemi **dy makro-fusha**:

a. **Fusha e shkurtesave shqipe** (vendëse), ku përfshihen të gjitha ato formime të tilla, trajta e plotë e të cilave lidhet me fjalë të burimit vendës (të shtresës vetjake të leksikut të shqipes); janë shkurtime emërtime që lidhen me ndërmarrje, institucione, shoqëri, agjenci etj., të cilat janë krijuar dhe veprojnë në vendin tonë. Të tilla mund të përmendim: KKS (Kryqi i Kuq Shqiptar), INSIG (Instituti i Sigurimeve), DSHP (Drejtoria e Shëndetit Publik), ATSH (Agjencia Telegrafike Shqiptare) etj.

b. **Fusha e shkurtesave huazime**. Kushtet në të cilat fjala e huaj ka hyrë në gjuhën shqipe¹⁹, mund të vlejë edhe për shkurtesat, d.m.th. kur janë ndërkombëtare, kur e kërkon një stil i caktuar i gjuhës, kur huazohen së bashku me objektin etj. Shkurtesat si **ndërkombëtarizma** përbëjnë numrin më të madh të shkurtesave të huazuara. Ato i përkasin fondit ndërkombëtar të shkurtesave, si: NATO (North Atlantic Treaty Organisation - Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior), UNICEF (United Nations International Children's Emergency Fund - Fondi Ndërkombëtar i Emergjencës për Fëmijët pranë Kombeve të Bashkuara etj. Këto shkurtesa nuk janë shqipëruar pasi edhe në gjuhët ku kanë lindur përfaqësojnë shkurtesa dhe nuk përdoren në trajtë të zbërthyer që më pas të përkthehen dhe të formohen shkurtesa në bazë të rregullave të gjuhës shqipe²⁰. Prandaj dhe në fjalor janë dhënë si shkurtesa të huazuara, me emërtimin e plotë në gjuhën dhënëse, si dhe me përkthimin përkatës në shqipe. Për këto shkurtesa nuk është e nevojshme të krijohen shkurtesa të reja nga përkthimi i tyre në shqipe.

Në median e shkruar gjejmë jo pak shkurtesa emërtime të

huaja, që dalin si formime kalimtare. Në përdorimin e përditshëm ndeshim kështu shumë shkurtesa në dy forma, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, zakonisht në anglisht. Të tilla mund të përmendim: USA (*United States of America*) dhe SHBA (*Shtetet e Bashkuara të Amerikës*), OSCE (*Organisation for Security and Cooperation in Europa*) dhe OSBE (*Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë*) etj. Këto shkurtesa vijnë si përkthim i trajtës së huaj dhe riformim i shkurtesës tashmë në gjuhën shqipe²¹. Derisa shkurtesa në shqipe të fitojë mëvetësinë dhe të njihet më mirë nga përdoruesi mund t'i ndeshim të dyja format. Në fjalor shkurtesat jepen së bashku me emërtimin e plotë në gjuhën dhënëse dhe shkurtesat gjegjëse së bashku me emërtimin e plotë në gjuhën shqipe.

Një çështje problemore është dhe ***drejtshkrimi i emërtimeve të shkurtuara***. Fjalori synon të kodifikojë edhe shkrimin e tyre.

Shkurtime rrokjesore a të pjesshme do të shkruhen me shkronja të vogla dhe me pikë në fund; p.sh. *prof., dok., agr.* etj. Kurse shkurtime e formuara nga shkronjat e para do të shkruhen me pikë pas çdo shkronje, si: *p.sh., d.m.th., p.e.s.* etj.

Shkronja e madhe është përgjithësuar pothuajse për të gjitha shkurtesat, Megjithatë duhet të rishitet kjo zgjidhje, sepse shqipja ka në përdorim shkronja dyshe, si ***dh, th, sh*** etj. Në fjalor kemi përdorur shkronjën e madhe vetëm për atë nistore; p.sh. PKKZh (*Projekti Kombëtar për Zhvillim*), FGjSSh (*Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*) dhe jo PKKZH (*Projekti Kombëtar për Zhvillim*), FGJSSH (*Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*) etj.

Nuk paraqesin probleme të natyrës shkrimore a drejtshkrimore ***shkurtesat rrokjesore***²². Ato shkruhen si fjalë e zakonshme, me shkronjë nistore të vogël dhe treguesit e eptimit i marrin në fund të temës, pa u ndarë prej tyre me vizë lidhëse; p.sh. *Albtelekom* (*Komunikimi telefonik shqiptar*), *Insig* (*Instituti i sigurimeve*) etj.

Në grupin e madh të shkurtesave (akronime) ndeshemi shumë shpesh me njësi homonime. Kjo bie në sy menjëherë në gjuhët me qindra mijëra njësi të tilla; si kemi thënë, në anglishte, p.sh. ka një fjalor me rreth 3.000.000 shkurtesa. Edhe në gjuhën shqipe ka shkurtesa homonime, si: KLSH (*Kontrolli i Lartë i Shtetit*) dhe KLSH (*Komisja Letrare e Shkodrës*); TVSH (*Televizioni Shqiptar*) dhe TVSH (*Tatim mbi Vlerën e Shtuar*); ISP (*Instituti i Studimeve Pedagogjike*), ISP (*Instituti i Studimeve Pediatrike*), ISP (*Instituti i Studimeve dhe i*

Projektimeve) etj.

Nuk ka dyshim që *ligjërimi publicistik është një nga krijuesit dhe përhapësit kryesorë të shkurtesave*. Në krijimtarinë letrare artistike, që është fusha më e lartë dhe më e ndërlikuar e gjuhës sonë letrare²³, shkurtesat thuajse mungojnë. Kjo lidhet me funksionin e veçantë të gjuhës në letërsinë artistike, që është funksioni estetik, ku gjuha jo vetëm kumton një informacion letrar, por edhe synon të ketë ndikim estetik, të ngjallë ndjenjën e së bukurës²⁴. Shkurtesat janë të pranishme edhe në botime të tjera, si në libra shkollorë e universitarë, në botime monografike e shkencore etj.

Fjalori, të cilin e përshkruam këtu, me lëndën e vet natyrisht, do të lehtësojë kodifikimin dhe shkodifikimin e mesazheve të ndryshme, të transmetuara edhe përmes emërtimeve të shkurtuara.

Shënime:

¹ Shih më gjerë H. F. Josef: *Lexikographie në Handbuch der Lexikologie*, Königstein 1985, f. 369

² R. Memushaj, Hyrje në gjuhësi, Tiranë, 2002 f. 154-158

³ Por zhvillimi i jashtëzakonshëm i shkencës dhe i teknologjisë kompjuterike nga fundi i shekullit XX e në vijim ka njohur edhe dy lloje të tjera fjalorësh: *fjalorë të lexueshëm nga makina* (në formë elektronike) (*Machine Readable Dictionaries*) dhe *fjalorë të përpunueshëm nga makina* (pjesë e sistemeve të teknologjisë gjuhësore) (*Machine Tractable Dictionaries*).

⁴ F. Leka, Z. Simoni, *Fjalor italisht-shqip*, Tiranë, 2006

⁵ P. Qesku, *Fjalor anglisht-shqip*, Tiranë, 2002

⁶ A. Dhrimo, *Fjalor gjermanisht-shqip*, Tiranë, 2002

⁷ H. Çipuri, *Shkurtesat dhe vendi i tyre në terminologjinë e sotme të gj. shqipe*, SF, 1988, 3, f. 132

⁸ R. c. Thomas, *Akronyms and Initialism Dictionary*, Detroit, 1970

⁹ R. d. Sola, *Abbreviations Dictionary*, Neë York, 1973

¹⁰ FGjSSH, Tiranë, 1980, f. 1879

¹¹ FGjSSH, Tiranë, 1980, f. 1879

¹² H. Çipuri, *Shkurtesat dhe vendi i tyre në terminologjinë e sotme të gj. shqipe*, SF, 1988, 3, f. 132-145

¹³ D. Garuci, *Mbi drejtshkrimin e shkurtimeve*, në Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe, Tiranë, 1972, f. 475-476

¹⁴ E. Angoni, *Shkurtesat dhe drejtshkrimi i tyre*, Gjuha jonë, 1989, 3, f. 22-23

¹⁵ H. Çipuri, *Shkurtesat dhe vendi i tyre në terminologjinë e sotme të gj. shqipe*, SF, 1988, 3, f. 132-145

¹⁶ D. Garuci, *Mbi drejtshkrimin e shkurtimeve*, në Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës